



Prishtinë: 30.04.2010

Kodi i ZRRE-së: V\_243\_2010

Nr. i Referencës: ZRRE/DMK\_V\_371\_03\_10

### Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kapitullit 3, Nenit 16 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë dhe procedurat e paraqitura nga palët;
4. Vendimin e DMK të ZRRE-së: **ZRRE/DMK\_V\_371\_03\_10** ;
5. Apelimi i konsumatorit me datë 02.04.2010;
6. Nenin 18 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë; dhe

**Në mbledhjen e mbajtur më 30.04. 2010, nxori këtë:**

### VENDIM

**PRANOHET** ankesa e konsumatorit Rabije Sylja (shifra e konsumatorit në KEK: DPR – 205914) nga Prishtina, si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.

### Arsyetim

Konsumatori në ankesën e tij drejtuar DMK-së në ZRRE me datë 28.12.2009 ka apeluar përgjigjen e KEK Sh.A – Divizioni i Furnizimit – Departamenti për Konsumatorë të datës 22.06.2009 lidhur me kontestimin e ngarkesës së shfrytëzimit të paautorizuar.

- Me datë 13.06.2008, punëtorët e autorizuar të KEK-ut kanë inspektuar pikën matëse te konsumatori dhe kanë bërë regjistrimin e të dhënave teknike të pikës matëse.  
**Provë:** Procesverbali i KEK-ut nr. 0143318 të datës 13.06.2008
- Me datë 21.08.2008 punëtorët e autorizuar te KEK-ut kanë inspektuar pikën matëse te konsumatori dhe kanë bërë ndërrimin e njehsorit elektrik, ku kanë hequr nga matja njehsorin elektrik nr. 25257964 dhe kanë vendosur për matje njehsorin nr. 1981571.  
**Provë:** Vërtetim mbi ndërrimin e njehsorit elektrik nr. 005211 datë 21.08.2008
- Me datë 06.12.2008 punëtorët e qendrës e kalibrimit kanë bërë kontrollimin detal të njehsorit elektrik nr. 25257964, ku është konstatuar se njehsori elektrik vulat (bllombat) shtetërore i ka në rregull, nga ana e jashtme njehsori qelqin e ka të krisur, për rreth qelqit nga ana e poshtme është futur shiriti filmik ku është pengu puna e diskut si dhe në brendi të njehsorit ka pluhur të shiritit filmik.  
**Provë:** Procesverbali me nr. 2/6 i datës 06.12.2008

- Me datë 15.04.2009 KEK-u e ka ngarkuar konsumatorin me ngarkesë për shfrytëzim të paautorizuar me anë të faturës DPR09HP07543 në vlerë prej 1,857.48 €.  
**Provë:** Fatura DPR09HP07543 e datës 15.04.2009
- Me datë 15.06.2009 konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KEK duke kundërshtuar ngarkesën për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike.  
**Provë:** Ankesa e konsumatorit në KEK
- Me datë 22.06.2009 Departamenti për Konsumator në KEK i është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar dhe duke thirrur në procesverbalin e kontrollës dhe të kalibrimin.  
**Provë:** Përgjigja e KEK-ut e datës 22.06.2009
- Me datë 28.12.2009 konsumatori ka apeluar përgjigjen e KEK-ut në DMK të ZRRE-së.  
**Provë:** Ankesa e konsumatorit në DMK të ZRRE-së
- Me datë 19.03.2010, DMK e ZRRE-së ka nxjerrë një vendim në lidhje me ankesën e konsumatorit ku ka refuzuar pjesërisht ankesën e konsumatorit.  
**Provë:** Vendimi ZRRE/DMK\_V\_371\_03\_10, të datës 19.03.2010
- Me datë 02.04.2010, konsumatori ka parashtruar ankesë në Bordin e ZRRE-së, duke kundërshtuar vendimin e DMK-së nr. ZRRE/DMK\_V\_371\_03\_10.  
**Provë:** Ankesa e konsumatorit në Bord të ZRRE-së

Bordi i ZRRE-së ka analizuar Vendimin e lëshuar nga DMK: ZRRE/DMK\_V\_371\_03\_10 dhe ka vërejtur se nuk ka elemente të mjaftueshme për të ngarkuar konsumatorin me ngarkesë për shfrytëzim të paautorizuar. Sipas analizave të bëra konsumit të energjisë elektrike të konsumatorit shihet se konsumi i energjisë elektrike me njehsor të vjetër dhe me njehsor të ri nuk ka dallim. Bordi i ZRRE-së pas analizimit të vendimit dhe dokumentacionit të prezantuar **pranon** ankesën e konsumatorit dhe kërkon nga KEK-u që të shkarkojë konsumatorin nga fatura DPR09HP07543 në vlerë 1,857.48 €.

**Këshillë Juridike:** Kundër këtij Vendimi, pala ka të drejtë të iniciojë procedurë gjyqësore në Gjykatën Kompetente, brenda **katërmëdhjetë (14) ditësh** prej ditës së pranimit të këtij Vendimi.

#### **Bordi i ZRRE-së**

---

Dr. Ali Hamiti, kryesues

---

Theranda Beqiri, anëtare

---

Përparim Kabashi, anëtar

---

Blerim Koci, anëtar